REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, web:www.bashkiaroskovec.gov.al, nr.tel : 0387 80242

SHPALLJE PËR VENDE TE LIRA PUNE

(Specialist)

Lloji i diplomës "Arkitekt, Inxhinier Ndertimi"
Niveli minimal i diplomës "Diplome e Nivelit te Pare"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 64 "Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", gërma "g", "Emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të Bashkisë,ligjin Nr.8335 datë 23.04.1998,ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Neni 19 "Punësimi", Vendimit të Kryetarit të Bashkisë date 02.02.2016 "Për miratimin e structures organizative dhe pgat perkatese per Bashkine Roskovec dhe Njesite Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum per vitin 2016", Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të njësive administrative", Bashkia e Roskovec njofton per vende te lira pune si më poshtë:

Bashkia e Roskovec njofton per vende te lira pune si më poshtë:

- 2(dy) specialist Arkitekt/Inxhinier Ndertimi
-

Detyrat Kryesore

- Llogarit volume të punimeve sipas projekteve;
- Aplikon çmimet sipas llojit të punimeve dhe analizon çmime të reja (kur mungojnë në manual);
- Llogarit mbikëqyrjet dhe kolaudimet sipas vlerave të preventivave;
- Mbikqyr dhe kontrollon funksionimin Regjistrit Kombëtar te Planifikimit të Territorit për Bashkinë, inventarit elektronik dhe shkresor i cili ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur.
- Përpilon kthim e përgjigjeve kundrejt subjekteve të ndryshme private apo shtetërore në lidhje me kërkesat e tyre për të drejtën e informacionit;
- Kryen inspektimin e situatës në terren për të gjitha shqyrtimet e aplikimeve, për leje punimesh dhe jep sugjerime për zgjidhje në kohë sa më të shkurtër, nëse ka probleme;
- Verifikon në terren kërkesat e ankesat e ardhura në adresë të Drejtorisë dhe përgatit përgjigjet për këto probleme;
- Përgatit informacione të detajuara teknike në lidhje me kontrollin e zbatimit të lejeve të punimeve;
- Identifikon problematikat e rezultuara gjatë kontrolleve dhe harton brenda afateve të përcaktuara njoftimet zyrtare për subjektet ndërtuese në rastet kur realizimi i punimeve, nuk rezulton në përputhje me kushtet e lejes së dhënë;
- kontrollon afatet e përfundimit të punimeve për subjektet që janë drejt përfundimit të afatit të lejes së punimeve;

Kriteret e vecanta per kete pozicion jane:

a) Te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare, Diplomë "Bachelor".Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi,
b) Te kete te pakten 2 vite eksperienc punë,
c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidatët për pozicionet e mësipërme duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;

- Të ketë të kryer arsimin e larte dega Arkitektor ose Inxhinier Ndertimi;

- Të ketë njohuritë bazë të punës në kompjuter:

- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;

- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;

- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

-Kualifikime te tjera.